

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-32
N34

FILIP NDOCAJ

TREGIM

DUKE
KERKUAR
LUMTURINE

814-52

N 54

FILIP NDOCAJ

DUKE KËRKUAR LUMTURINË



— Tregim —

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Pavioni im. Një grykë dhembjesh, rënkimesh, shpresash.

Njëzet krevatë, njëzet drama, njëzet dridhje shpresash në kujdesin tim, në punën time e të profesorit, me dashurinë e pa fund ndaj jetës.

Është vizita e pasdites. Kontrollon grafikun e temperaturës në çdo tabelë mbi kokën e secilit krevat. Me mua është kryeinfermierja dhe infermierja e turnit të natës. Jap porositë e fundit e dal nga pavioni me një gëzim që ma pushton të gjithë qenjen. Asnjë rast keqësimi, asnjë ngritje temperature, asnjë ankim nga ana e pacientëve të mi. Të gjithë janë të qetë, të gjithë më premtajnë se do të marrin mjekimet e natës. Më urojnë natën e mirë, edhe ata që sapo kanë dalë nga salla e operimit. M'i kanë qepur sytë e s'm'i shqitin, si të donin të lypnin ndihmë. Po unë nuk flas. Nuk ndalem as te ndonjë pacient, siç e kam zakon të ndërroj dy tri fjalë me ta. Sot mbasdite s'e kuptoj sepse dua të largohem sa më shpejt nga spitali, të pastroj mushkëritë e mia nga duhma e anesteziqëve që kam thithur gjatë pesë operacioneve.

Në korridorin e qetë, si hije të bardha lëvizin infermierët, që shkasin mbi këpucët e gomës. S'kuptoj pse këta shokë pune sot më duken qenje të shkreta, që duhet të jetojnë tërë jetën në mes të sëmurëve.

E, pra, e di që edhe këta janë si unë, në shërbimin më njerëzor që mund t'i jepet njeriut. Shumica e tyre kanë kush dhjetë e kush njëzet vjet duke bërë po këtë punë. Janë mësuar me këtë ambient, jashtë të cilit s'rrojnë dot. Si unë, si unë! Po s'di sepse duke i shikuar kaq të preokupuar në punën e tyre, pyes veten. Kanë jetë personale këta? Apo edhe këta gjithë gazin e jetës e gjejnë këtu, në këtë punë? Më duken si ushtarët e sulmit kundër armikut të vetëm, vdekjes, që qëndron mbi krevatet e qenjeve njerëzore dhe shpresën e kanë te ne! Por ç'kam kështu sot?!

Si e habitur, i zgjas më shumë se kurrë porositë për pacientët e operuar sot, për djalin e vogël, të cilit i ishin ngatërruar zorrët e desh na iku në operacion e sipër, për plakun që e liruam nga një tumor afër kurrizit, për mekanikun që kishte pësuar frakturë të koskës tibiale e që sapo t'i dalë anestezia, mund të ndjejë dhembje aluçinante.

Pastaj shkoj nga pavioni i grave të sigurohem mbi gjendjen e dy të operuarave të ditës. Të dyja janë në gjumë. Nga goja u del firoma e rëndë e anestezikut.

Doktor Agimi qëndron para portës së dhomës sonë, i veshur. Ai është i shqetësuar, se unë jam vonuar. Më thërret:

— Doktoreshë! ka gjysmë ore që kemi kryer orarin e punës, e unë ka pesë minuta që ju pres të dalim.

— Më falni, doktor, po s'qe nevoja të më prisnit!

— Po ju e dini, Evelinë! Ne e kemi si rregull: bashkë e morëm punën, bashkë duhet ta lëmë.

Ja ndërpres e mërzitur:

— Unë s'kam njeri që të më presë në shtëpi vec nënës. Ndërsa ju, doktor...

Po më mbetet fjala në gojë. Doktorin më shikon me vërejtje. Sytë e tij sikur duan të më thonë: «Eh, rini! Të isha dhe unë si ti!» Mua më pëlqen të dal nga puna vetëm. Nuk dua të jem e detyruar t'ua vë veshin fjalëve të shokëve, të flas me ta. Më pëlqen të futem kështu e vetme mes turmës së kalimtarëve. Më pëlqen ta ndjej, ta shijoj afshin e jetës, mes njerëzve të gjallë, të shëndoshë, që ecin rrugëve të Tiranës. Dua kësisoj të harroj dhembjen e madhe, kolektive, që jetoj në spital, mes pacientëve të mi. E përpiqem në këtë mënyrë të mbush një ndjenjë zbrazësie që më mbërthen ndonjëherë.

Buzëqesh. Dua që doktor Agimi të besojë që jam ashtu siç më di ai: një çupë e çuditshme, që nuk dëshiron t'ja tregojë askujt jetën e saj personale. E doktorin më thotë:

— Eh, shoqja Evelinë, ti ndonjëherë mërztitesh kot! Kur jemi të rinj, s'e kuptojmë sa të lumtur jemi. Ti tani mund të vesh e të gëzosh çlodhjen që e meriton. Unë kam më pak kohë se ti për studime. Më duhet të kujdesem për ushqimet, pastaj duhet të vete e të marr fëmijën, më të voglin, në kopsht e të merrem dhe me detyrime të tjera familjare. Më duhet t'i qëndrojnë pranë të voglit deri sa të bjerë ai dhe të tjerët në gjumë. Ai do dhe të lozë me mua. Kurse ti ke atë nënë që të adhuron e të lë të merresh sa të duash me punën tënde. Ti mërztitesh sepse kthehesh në shtëpinë tënde si vilë, në atë qetësi ideale për studime, në çdo kohë të ditës e të natës!

Eh, doktor Agimi! Edhe ky mendon si mjekët e

tjerë, moshatarët e mi, që kanë thurur lloj-lloj le-
gjendash rreth jetës sime personale. Ata mendojnë se
unë, pas ndarjes me Tuçin, kam një dashuri të ma-
dhe, me të panjohurin për të cilin kam braktisur
shokun tim më të dashur. Atyre s'u shkon nëpër
mend që unë s'kam njeri, as jashtë as në shtëpi.
Sidomos tani, pas vdekjes së tim eti, fill e vet-
me në atë shtëpi me nënën, e ndjej veten pa
njeri në botë! Qysh nga koha që u bë shkaktare
të ndahesha me Tuçin, unë edhe nënën e shikoj
më ndryshe e nuk më pëlqen të bisedoj gjatë
me të. I përgjigjem doktor Agimit si duke ironizuar
me vete:

— Po, po! Shtëpi më vete...

— Pse shaka i thonë të kesh mundësi të studjosh
sa herë që do? — thotë ai.

I hip biçikletës dhe ikën duke më uruar natën
e mirë. Unë dal në trotuarin përballë spitalit tonë.
Dua të marr autobusin te ndalesa përballë konviktit
të djemve të fakultetit tonë. Qëndroj aty, ndërsa
nis i heshtur një vesim shiu. E shikoj me mall
fasadën e këtij konvikti dhe para syve të men-
djes më parakalojnë kujtime të panumërta të një
lumtërie.

Autobusi zbret, duke ardhur nga Kinostudjua i
mbushur plot e përplot. Megjithatë, shoferi ndalon
para meje. Ai më hap portën e përparme, më fton të
hip kundra rregullit. Por unë e falënderoj me kokë
dhe i them të shkojë. Ka disa ditë që s'duroj njeri
të më afrohet pranë trupit, siç ngjet zakonisht ndër
autobuse. Diçka më shtyn të nisem në këmbë. Por

ndjehem e lodhur dhe bëj dy-tre hapa drejt spitalit nr.1 për të pritur autobusin tjetër. Jam duke ju afruar trotuarit para stacionit të autobusit. Përpara meje qëndron një burrë i shkurtër me xhakëtë të shkurtër sportive prej leshi të trashë dhe me këmi-shën e bardhë të zbërthyer. Është Tuçi. Më përvëlton shikimi i tij i vesuar nga pikëla shiu mbi qelqet e syzave.

Tërë trupi im priret nga ai.

Dua t'i flas. Dua ta ftoj të afrohet nën çadrën time të vogël, se unë kam pardesy e ndërsa ai është në xhakëtë. Unë pres nga ai një fjalë, një përsëndetje sado të ftohtë, së paku një lëvizje koke. Por vjen autobusi e ai largohet. Kalon në anën tjetër të rrugës, në trotuarin që është nga spitali. Unë ngjit shkallët e autobusit «Ikarus» me këmbët që mezi më mbajnë. Më duken ato tri këmbë shkalle një lartësi mendjemarrëse. E shoh nga dritarja atë, që ecën ngadalë, pa e vënë re shiun që bie duke u shpeshtuar.

Prapa krahëve të mi dëgjoj një zë të njohur:

— Gjithmonë i hutuar doktor Tuçi! Kushedi ç'e pandehu autobusin dhe iku.

Është doktor Flamuri, një shok kursi në fakultet. Tani punon në spitalin nr. 1. Është një tip që s'e kam pasur qejf kurrë. Ai më pëshpërit te veshi.

— Si duket, iku nga ti, Evelinë. Ja prove këmbët. Nuk e pe që shkonte si i vrarë?

Unë eca përpara nëpër rruginën e autobusit me pak njerëz. U ndala pranë portës së zbritjes me mendimin që po të më afrohej ai, do të zbrisja në ndalesën e parë. Isha ndezur në fytyrë, sepse më tingëllonin aq ofenduese fjalët e doktor Flamurit, aq sarkastike. Unë e di se s'do të jem e zonja më t'ja pengoj këmbët atij që u largua nga unë. Po pse të

kem iluzione të kota? Ai u largua nga unë si nga një qenje e pështirë, si nga një qenje meskine! Sa e kam fyer unë atë. Sa e kam poshtëruar dashurinë e tij të pastër, gjithë afsh dëshire të pafund, atë dashuri që ja blatova pas kaq e kaq provash e vitesh admirimi të vazhdueshëm. E unë, kundra dëshirës sime, ndoqa këshillat e asaj nëne që më pret tani si «thesarëka e mamit». E ai, e ndjeja me gjithë rekëtimat e zemrës, ishte dashuria, ishte gjithë gazi i jetës sime, ishte më i miri i të gjithëve.

Lëvizje hapash nga porta e daljes. Autobusi ndalet. Hapet porta, dhe zbresin pak njerëz. Një mori është e grumbulluar para portës së pasme që të ngjiten në autobus. Ndjej sytë e dëshiruar të Flamurit, që më afrohet, hapat e tij, që më ndiqnin dikur nëpër korridoret e fakultetit.

Shoferi përkulet të manovrojë levat e mbylljes së portës së përparme. Shkas jashtë autobusit në çastin kur ai vihet në lëvizje. Porta mbyllet, dhe unë shikoj Flamurin, që zihet me shoferin. E dëgjoj tek i thotë: «Nuk jam taksi, shoku doktor! Jam urban e i kam minutat të llogaritura!»

Shiu i imët më freskon fytyrën. Më duket sikur kam shpëtuar nga një skenë e papëlqyer, që sigurisht do të kishte ndodhur midis meje e Flamurit. Qëndroj nën çatinë e një barrake kinkalerie të mbyllur. Ngjishem në dërrasën e barrakës. Uji më ka njomur çorapet, që, si një gjuhë e pështirë, ngjishen pas pulpave e gjunjëve të mi. Të ftohtët më pushton gjithë trupin kur ndjej se një curril shiu ka rrëshqitur nga streha e barrakës dhe ka rënë në zverkun tim e nëpër lugun e shpinës gjer poshtë. Ndërroj vend, por

i ekspozohem më keq stuhisë. Provoj të hap çadrën, të largohem nga ajo çati aq e pasigurt. Por çadra nuk hapet. Atëherë e vë mbi kokë, ashtu si vija çantën e librave dikur, kur isha nxënëse e më zinte shiu pa çadër udhës.

Bëhem gati të largohem, të futem në ndonjë rrugë anësore të arteries së gjerë të rrugës Bajram Curri, kur sytë e mi ndalen në figurën e njohur. Ai po vjen.

Ndjej hapat e ngadaltë, që llapaçiten nëpër ujët e trotuarit. Ai ndalet nën atë strehë përballë ndalesës së autobusit. Më duket vetja në një gjendje qesharake, sikur isha fëmijë e i fshiheshim njëri-tjetrit duke luajtur kukafshehti. Tani s'kam ç'të pres më. I afrohem. Ai është pa gjyslykë. Flokët e paktë i janë ngjeshur pas kokës gjysmë tullace. Shiu e ka bërë qull.

A është një çast shkitës apo një autosugjestionim imi?

Unë varem në sytë e tij...

E ai vuan, e shikoj sa shumë vuan!

Duart i dridhen ndërsa me majë të gishtërinjve prek nga jashtë xhepat. Më në fund, nga xhepi i prapmë i pantallonave nxjerr një shami, fshin fytyrën e duart, më në fund, kokën, e ujdís flokët. Pastaj e shtrydh shaminë dhe e fut në xhepin e xhaketës. Do të vazhdojë rrugën, të dalë rishtas nëpër atë dallgë shiu. Po unë s'duroj më. Shtrij dorën drejt tij, si të doja ta ndaloja, dhe i them:

— Qëndro, Tuç! Je bërë pellg. Tani vjen autobusi e ikim...

Ai më shikon, siç shikojmë njeriun që nuk e njohim, ose që nuk duam ta njohim. Më keq akoma! Ai ul kokën sikur s'do as të më shikojë më. Ngre jakën, e shkund nga shiu dhe bëhet gati të ikë. Unë i afrohem akoma më pranë e i pëshpëris:

— Tuç, rri.... të lutem! — Zëri im tingëllon si atëhere kur e lusja të qëndronte në shtëpinë tonë, të studjonte me mua. Ndoshta lutja ime qe dhe më e fortë, sepse ai qëndroi. Më shikoi drejt në sy. Foli lehtë, si nëpër dhembë:

— Më njihke akoma? Nuk ma paske harrue emrin?..

— Tuç, Tuç... kaq shumë më urreke ti?

— Gjegju, s'më paske harrue?

— Jo, Tuç, megjithëse kam bërë çmos! Por e dija se ju malësorët jeni hakmarrës dhe urreni fort, sidomos kur ju fyejnë.

E ndjej se kam gabuar. Ai tani më gjykon si një aktore të dobët që ka bërë njëqind e një prova për të luajtur sa më natyrshëm në skenë e kur është në skenë, e kupton se zëri i saj tingëllon krejt artificial, krejt falso. E kuptoj tani se atij i është mbushur mendja që unë kam zbritur e jam fshehur aty qëllimisht që ta takoj, që t'i flas. E nuk përmbahem më:

— Mos më shiko kaq egër, të lutem. Ti ndoshta kujton se unë kam dalë këtu të të pres, që të të jap shqetësime të tjera, por unë...

Nuk vazhdoj jo pse s'di ç't'i them, por sepse ai më ndërpret duke m'u drejtuar:

— Do të vazhdosh të tallesh me mua? Ka qenë ky stili yt, të shikosh djemtë duke t'u lëpirë pas, si kone që presin kafshitën e një shikimi tënd mëshirues, thërmijën e buzëqeshjes sate. Vazhdo, të lutem, edhe tani që s'je ma ajo Evi i mamasë, lulja mos më prek e gjithë qytetit. Fol ndryshe tani, fol si shoqe, mjeke! Ç'ke dalë të më thuash. Mos të shqetëson kush? Do ndihmë edhe tani, nga unë, nga një copë malok veriu, siç më ka quajtur nëna jote?